

MINISTRI HASANI NË NJU JORK PËR JAVËN E NIVELIT TË LARTË TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-SË.

Nju Jork, 22-30 shtator 2024

Në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama, ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh si dhe ka zhvilluar disa takime dypalëshe me homologë të tij nga Azerbajxhani, Bullgaria, Qipro, Egjipti, Gjeorgjia, Kazakistani, Kirgistani, Malta, Ishujt Marshall, Mongolia, Maroku, Nikaragua, Turkmenistani, Turqia dhe Uzbekistani. Ministri Hasani mori pjesë në takimin “Beijing+30: drejt një bote me barazi gjinore”, në mëngjesin e punës me Ministrat e Jashtëm të grupit të Miqve të Ballkanit Perëndimor, në takimin për antisemitizmin etj. Pala shqiptare bashkëorganizoi takimin për situatën në Sirinë verilindore, ku Ministri Hasani theksoi se institucionet shqiptare kanë adoptuar dhe zbatuar me sukses një model për identifikimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe përhapjes së radikalizmit. Gjatë punimeve të AP, më shumë se 30 vende, përfshirë Shqipërinë, miratuan Deklaratën e Përbashkët të Mbështetjes për Rimëkëmbjen dhe Rindërtimin e Ukrainës.

KRYESIMI SHQIPTAR I NISMAVE RAJONALE, MINISTRI HASANI: ZGJERIMI, PROJEKTI MË I SUKSESSHËM I BASHKIMIT EVROPIAN

Gjatë takimeve të nivelit të lartë të zhvilluara në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Shqipëria, si vend kryesues i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) Nismës së Evropës Qendrore (CEI) dhe Kartës SHBA-Adriatik (A-5) rikonfirmoi angazhimin e saj për të përshpejtuar procesin e integritit evropian të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Qendrore.

MINISTRI HASANI TAKON PETER SZIJARTO: HUNGARIA PRO PËRSHPEJTIMIT TË PROCESIT TONË TË INTEGRIMIT NË BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një takim me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Hungarisë, Peter Szijarto. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e Hungarisë për avancimin e procesit integruar të Shqipërisë dhe gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, duke shprehur besim të plotë për përshpejtimin e këtij procesi gjatë Presidencës hungareze të Këshillit të BE-së.

MINISTRI HASANI PRET HOMOLOGEN FINLANDEZE, VALTONEN: VLERËSIM PËR ANGAZHIMIN NË OSBE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një takim dypalësh me Ministren e Punëve të Jashtme të Finlandës, Elina Valtonen. Ministri Hasani u shpreh se Shqipëria ka përparuar në zbatimin e axhendës së reformave për integrimin në BE, teksa theksoi rëndësinë e përshpejtimin të procesit të integritit për vendet e rajonit.

MINISTRI HASANI NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË JASHTËM TË KOALICIONIT GLOBAL KUNDËR ISIS

Uashington - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të Koalicionit Global Kundër ISIS, nën kryesimin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Në këtë aktivitet, i cili u drejtua nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, Antony Blinken, morën pjesë Ministrat e Jashtëm të 87 vendeve anëtare të Koalicionit për të trajtuar çështje me rëndësi në kuadër të luftës ndaj ISIS.

SAMITI I GRAVE AFGANE, MINISTRI HASANI: SHQIPËRIA, PJESË E PËRPPJEKJEVE NDERKOMBËTARE PËR PAQE DHE STABILITET

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, në fjalën hapëse në Samitin e Grave Afgane, vlerësoi qëndrimin dhe guximin e grave afgane kundër masave diskriminuese të vendosura nga regjimi taleban, teksa ritheksoi se Shqipëria vijon të jetë pjesë e përpjekjeve aktive ndërkombëtare për të sjellë paqe dhe stabilitet në Afganistan. Ministri Hasani zhvilloi një takim me të Dërguarën Speciale të Shteteve të Bashkuara për Gratë, Vajzat Afgane dhe Zyrën për të Drejtat e Njeriut për Çështjet Globale të Grave, Rina Amiri, duke vlerësuar punën e zyrtares së lartë për fuqizimin e rolit të grave në shoqëri.

FORUMI STRATEGJIK I BLEDIT, MINISTRI HASANI THEKSON PËRPARIMIN E SHQIPËRISË DHE ANGAZHIMIN PËR INTEGRIM

I ftuar në Forumin Strategjik të Bledit, Ministri Hasani parashtriu përparimin e rëndësishëm që ka bërë Shqipëria, në udhëtimin e saj drejt integritit evropian, teksa vuri në dukje përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë për të vazhduar me zbatimin e reformave të domosdoshme drejt anëtarësimit në BE. Gjatë Forumit Strategjik të Bledit, kryediplomati shqiptar zhvilloi disa takime dypalëshe me homologë dhe zyrtarë të lartë që ishin të pranishëm.

TIRANA CONNECTIVITY FORUM, HASANI: MEKANIZMAT E PROCESIT TË BERLINIT TË INTEGROHEN MË MIRË ME ATO TË BASHKIMIT EVROPIAN.

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani mori pjesë në edicionin e 10-të të Tirana Connectivity Forum (TCF24), ku theksoi se në rajon, mes fqinjëve, objektivat e përbashkëta gjeopolitike, ekonomike dhe sociale duhet të jenë prioritet dhe se mekanizmat e Procesit të Berlinit duhet të integrohen më mirë me ato të Bashkimit Evropian.

LIGJËRATË MBI PRIORITETET E PRESIDENCËS HUNGAREZE TË KËSHILLIT TË BE-SË: ZGJERIMI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL NË FOKUS

Në MEPJ zhvilloi një ligjëratë mbi përparësitë e Presidencës Hungareze të Këshillit të Bashkimit Evropian, me theks të veçantë në zgjerimin e BE-së, z. Márton Ugródsy, Zëvendës Sekretar Shtetit në Zyrën e Kryeministrit të Hungarisë dhe Drejtori Politik në Zyrën e Kryeministrit. Zyrtari i lartë hungarez trajtoi çështjet e sigurisë në rajon, politikën e jashtme hungareze ndaj Ballkanit Perëndimor dhe perspektivat e lidhshmërisë dhe bashkëpunimit, në një kontekst më të gjerë.

SHPËRNDAHEN RRETH 14 MIJË TEKSTE SHKOLLORE PËR FËMIJËT NË DIASPORË

Rreth 14 mijë libra shkollorë janë shpërndarë nxënësve në diasporën shqiptare, ku numërohen rreth 20 mijë nxënës që frekuentojnë kurset e gjuhës shqipe në të gjithë botën, e të cilët mund të zgjedhin të përdorin edhe tekstin digjital krahas atij fizik.

